

Nr. regj. 14849/12

|                      |  |            |  |
|----------------------|--|------------|--|
| REPUBLIKA E KOSOVES  |  | PRISHTINE  |  |
| Duke marrë parveshje |  | 03-3559/12 |  |
| DPK/DMP              |  | 05-10-2012 |  |
| 02                   |  |            |  |

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Ilir Pushka nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 te Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave te Zyrtareve te Larte Publik nr. 03/L-151, e ne baze te nenit 73.73.195, 199 te Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 27 .09. 2012, merre këtë:

### AKTVENDIM

I PANDEHURI: Ilir Pushka, i lindur më 04.05.1972 në Prishtina, ku edhe tani jeton ne lagjen Velania 3/17 ne Prishtine, i martuar baba i dy fëmijëve, Këshilltar politik ne MFSK ne Prishtine, me shkolim superior, i gjendjes se mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

### Ë shtë pë r g j e g j ë s

Sepse me si Zyrtar i larte Publik, ne Pozite Këshilltar Politik ne Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë se Kosovës - Prishtine, nuk e ka bere deklarimin e rregullt te gjendjes se pasurisë ne Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 5,6 lidhur me nenin 5.1 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtareve te Larte Publike**, andaj te pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

### DENIMI

Me gjobë në shumë prej **1000 (njëmijë)** Euro. Gjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po qe se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njejtja do ti zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njejtë sikurse gjobën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

### A r s y e t i m

**Agjencinë Kundër Korrupsionit ne Prishtine**, parashtroi kërkesën nr. 01 1602 të dt. 30.04.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj te pandehurit te shënuar për kundërvajtjen e precizuar si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen ne pyetje te pandehurit i cili ne mbrojtjen e vet deklaroi se si Këshilltar Politik ne MFSK, nuk ka pasur njohuri se ishte i obliguar ta beje deklarimin e pasurisë ne Agjencinë Kundër Korrupsionit, pasi kontrata e punës për staf politik janë kontrata te përkohshme. Me tej shton se askush nuk e ka njoftuar për këtë obligim si dhe askush nuk i ka dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë ne Agjencinë Kundër Korrupsionit. Fatmir Muqollin, pika kontaktuese ne mes te Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ministrisë Forcës dhe Sigurisë së Kosovës ne Prishtinë, cili ka deklaruar: se kishte njoftuar te pandehurin lidhur me obligimin për deklarimin e pasurisë ne Agjencinë Kundër Korrupsionit ne Prishtine si dhe i kishte dorëzuar formularin për plotësim përmes Bajram Kelmendit, Shef i kabinetit te Ministrit ne MFSK.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK andaj të LMK-ës të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit të pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngajshme.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

**Lindita Jakupi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksë.